



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 1/23 Nr. i faq./Br.str/No.pg 171

Data/Datum/Date 22.12.2023

Në mbështetje të nenit 12, i paragrafit 2 të shkronjës (d), nenit 17 të shkronjës (a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 i paragrafit 1 të pikës 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 i paragrafi 1 të pikës 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 i paragrafit 1 dhe 2 të pikës 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.12.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3624/23 i datës 08.12.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur "Rimnik", me kulturë bujqësore, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-08152-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2762m² (dymijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror) e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit, të jepen në shfrytëzim në sipërfaqe prej 2000 m² (dymijë metra katror).
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe dhënia e mundësisë së qytetarëve që të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies**

në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.171/23
Me datë:27.12.2023

